


# PERCEPTIMET E QYTETARËVE MBI SIGURINË PUBLIKE DHE KËRCËNIMET NDAJ SIGURISË KOMBËTARE NË KOSOVË



## Autorë:

Dea Fetiu, Dorjeta Rukiqi

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga anketa e Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e iniciuar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme lidhur me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

**Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.**

Financohet nga :



Konsorciumi i drejtuar nga:





# **PERCEPTIMET E QYTETARËVE MBI SIGURINË PUBLIKE DHE KËRCËNIMET NDAJ SIGURISË KOMBËTARE NË KOSOVË**

Shkurt 2023

# TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e figurave.....	1
Përmbledhje e përgjithshme.....	2
Hyrje.....	3
Methodology.....	4
1. Siguria Publike .....	5
1.1. Kërcënimet dhe rreziqet nga COVID-19 .....	10
1.2. Kërcënimet dhe rreziqet nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore..	11
2. Kërcënimet e sigurisë kombëtare.....	14

# TABELA E FIGURAVE

<b>Tabela 1</b>	Perceptimet e të anketuarve për perimetrin e sigurisë	<b>5</b>
<b>Tabela 2</b>	Perceptimet e të anketuarve mbi kërcënimet e sigurisë publike	<b>6</b>
<b>Tabela 3</b>	Shqetësimet e të anketuarve për mungesat e gjërave të domosdoshme	<b>8</b>
<b>Tabela 4</b>	Perceptimet e të anketuarve për COVID-19 dhe rrezikun e tij për shëndetin e tyre	<b>10</b>
<b>Tabela 5</b>	Perceptimet e të anketuarve për kontributin e vaksinës në frenimin e pandemisë	<b>10</b>
<b>Tabela 6</b>	Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen nëse kanë përjetuar dhunë në familje	<b>12</b>
<b>Tabela 7</b>	Perceptimet e të anketuarve mbi shkaqet e dhunës në familje	<b>12</b>
<b>Tabela 8</b>	Perceptimet e të anketuarve mbi masat institucionale që duhet të merren kundër dhunës në familje	<b>13</b>
<b>Tabela 9</b>	Perceptimet e të anketuarve mbi kërcënimet e sigurisë kombëtare	<b>14</b>

# PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky raport i Barometrit të Sigurisë së Ballkanit Perëndimor (BSBP) ofron një analizë të plotë të perceptimit të të anketuarve për kërcënimet e mundshme për sigurinë e tyre publike dhe sigurinë kombëtare në Kosovë në vitin 2022.

Të anketuarit përgjithësisht ndihen të sigurt në komunitetet e tyre të ngushta. Megjithatë, ndjenja e sigurisë gradualisht zvogëlohet ndërsa komunitetet rriten. Rreth 77% e të anketuarve deklaruan se ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre, ndërsa ndihen më pak të sigurt në shtetin e tyre (rreth 33%). Perceptimet e të anketuarve midis viteve 2021 dhe 2022 tregojnë një rënie të vogël të ndjenjës së sigurisë publike; në BSBP-në e mëparshme më 2021, ishin respektivisht 79 përqind dhe 40 përqind e të anketuarve që deklaruan se ndjeheshin të sigurt në shtëpitë e tyre dhe në shtetin e tyre. Pothuajse gjysma e të anketuarve ndihen të sigurt në hapësirën kibernetike.

Migrimi i të rinjve dhe profesionistëve (largimi i trurit) renditet si kërcënimi më i lartë për sigurinë publike, të cilin 83 përqind të të anketuarve e shohin si kërcënim ose kërcënim të lartë për komunitetet e tyre përkatëse. Kafshët endacake dhe abuzimi me drogën perceptohen gjithashtu si fenomene shumë kërcënuese. Për më shumë, të anketuarit përgjithësisht shqetësohen për mungesat e gjërave esenciale, por shqetësimet më të mëdha i shprehin për mungesën e energjisë elektrike.

Në nivel kombëtar, të anketuarit i shohin çmimet e rritura të mallrave si kërcënimin më të lartë ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës, pasuar nga kriza energjetike. Ndotja dhe ndryshimet klimatike, ekstremizmi i dhunshëm dhe COVID-19 shihen si kërcënimet më të ulëta për sigurinë kombëtare.

Kur u pyetën nëse COVID-19 vazhdon të rrezikojë shëndetin publik, pothuajse gjysma e të anketuarve u përgjigjën negativisht. Më tej, COVID-19 u rendit si kërcënimi më i ulët për sigurinë kombëtare të Kosovës. Mendimet janë disi të ndara kur bëhet fjalë për efikasitetin e vaksinës për pengimin e pandemisë COVID-19; megjithatë, 45 përqind e të anketuarve besojnë se vakcina kontribuoi në frenimin e pandemisë.

Sipas të dhënave të anketës, shkaqet kryesore të dhunës në familje në Kosovë janë kushtet e këqija ekonomike dhe niveli i ulët arsimor. Të anketuarit besojnë se ngritja e cilësisë së arsimit, dhe organizimi i më shumë fushatave vetëdijësuese janë disa nga masat që duhet të ndërmerren nga institucionet për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje.

# HYRJE

Ky raport, i publikuar në kuadër të anketës së BSBP-së 2022, synon të interpretojë perceptimet e të anketuarve për kërcënimet ndaj sigurisë së tyre publike dhe sigurisë kombëtare në Kosovë.

Raporti përbëhet nga dy kapituj: i) perceptimet mbi sigurinë publike, dhe ii) perceptimet mbi kërcënimet e sigurisë kombëtare. Kapitulli i parë analizon perceptimet publike mbi sigurinë publike, duke përfshirë atë se sa të sigurt ndihen të anketuarit në komunitetet e tyre dhe cilat çështje paraqesin kërcënim për mirëqenien e komuniteteve të tyre. Në kapitullin 1 të këtij raporti janë përfshirë edhe perceptimet publike për çështjen e dhunës në familje dhe perceptimet për rrezikun nga COVID-19.

Kapitulli i dytë përmban një pasqyrë të opinionit publik mbi kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë kombëtare. Kapitulli shqyrton perceptimet e të anketuarve mbi kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës përmes një vargu prej 16 pyetjesh në të cilat të anketuarve u kërkua të vlerësojnë nivelin e perceptuar të kërcënimit në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare.

Siguria publike është temë kyçe dhe e përsëritur, e shqyrtuar në anketat vjetore të BSBP. Edicioni i fundit i BSBP matë perimetrin e sigurisë që nënkupton ndjenjën e sigurisë midis të anketuarve në komunitetet e tyre të ngushtë, dhe në një varg pyetjesh të mbyllura ai matë perceptimet e të anketuarve mbi fenomene të ndryshme dhe si ata i perceptojnë këto fenomene si kërcënim përballë komuniteteve të tyre përkatëse.

# METODOLOGJIA

Të dhënat e anketës për këtë raport u mblodhën në kuadër të anketës së Barometrit të Sigurisë së Ballkanit Perëndimor (BSBP) përmes intervistave ballë për ballë me të anketuarit e zgjedhur rastësisht nëpër të gjithë Kosovën. BSBP është një projekt rajonal i udhëhequr nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe sondazhi u krye njëkohësisht në Shqipëri dhe në Serbi. QKSS bashkëpunon me Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (QSDQ) në Shqipëri dhe Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi për të zbatuar këtë projekt. Hulumtimi në terren u krye nga 25 shtatori deri më 2 tetor 2022. Pyetësi për anketën kryesisht përbëhej nga pyetje të mbyllura në formën e Shkallës Likert pesëpikëshe, të pasuara nga disa pyetje të hapura pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare për anketën numëronte 1,136 familje. Faza e parë e tërheqjes së mostrës u bazua në ndarjet administrative të Drejtorive Rajonale të Policisë së Kosovës, duke përfshirë tetë rrethet e mëposhtme: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Numri i anketave të kryera në secilin qark është tërhequr në proporcion me numrin e popullsisë për secilën komunë brenda rretheve përkatëse bazuar në regjistrimin e popullsisë së Kosovës të vitit 2011. Brenda komunave, mostra u shtresëzua në mostër urbane/rurale bazuar në numrin e familjeve në secilën zonë.

Modelet rastësore u përdorën për t'i zgjedhur familjet brenda vendeve të mostruara, ndërsa randomizimi brenda familjeve u bazua në metodën tjetër të ditëlindjes së të rriturve. Të dhënat u verifikuan në kohë reale përmes koordinatoreve në terren që vizituan një mostër të paracaktuar familjesh pas përfundimit të anketimit në familjet përkatëse, përmes kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa prej përgjigjeve kryesore, si dhe duke analizuar vijimsinë logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzhi i gabimit është 3 përqind me një interval besimi prej 95 përqind.



# 1. SIGURIA PUBLIKE

Perimetri i sigurisë është treguesi i parë që ka të bëjë me sigurinë publike dhe të anketuarit në përgjithësi shprehën një ndjenjë sigurie në komunitetet e tyre. Ata i shohin komunitetet e tyre më të ngushta si zonat më të sigurta dhe ndjenja e sigurisë gradualisht zvogëlohet ndërsa komunitetet rriten.

**Shtëpitë** shihen si vendet më të sigurta, me 92 për qind të të anketuarve që i vlerësojnë ato si kryesisht ose shumë të sigurta, pasuar nga **lagjet** me 89 për qind dhe **fshatrat/qytetet** me 85 për qind. **Shteti** përgjithësisht vlerësohet si zona ku të anketuarit ndihen më pak të sigurt, megjithëse më shumë se gjysma e të anketuarve ndihen kryesisht ose shumë të sigurt, me 59 përqind. Për më shumë, BSBP ka matur perceptimet e të anketuarve për sigurinë në **hapësirën kibernetike**, ku gati gjysma e tyre, konkretisht 48 për qind, treguan se ndihen të sigurt kur përdorin internetin.

**FIGURA 1** PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE PËR PERIMETRIN E SIGURISË SA NDJEHENI TË SIGURT:

## NË SHTËPINË TËNDE

Shumë i/e sigurt	77%
Kryesisht i sigurt	15%
Deri diku	6%
Kryesisht i pasigurt	1%
Shumë i/e pasigurt	1%
Nuk e di/Nuk kam mendim	0%



## NË LAGJEN TËNDE

Shumë i/e sigurt	68%
Kryesisht i sigurt	21%
Deri diku	9%
Kryesisht i pasigurt	1%
Shumë i/e pasigurt	1%
Nuk e di/Nuk kam mendim	0%




## NË FSHATIN/QYTETIN TËND

Shumë i/e sigurt	59%
Kryesisht i sigurt	26%
Deri diku	12%
Kryesisht i pasigurt	2%
Shumë i/e pasigurt	1%
Nuk e di/Nuk kam mendim	0%



## NË SHTETIN TËND

Shumë i/e sigurt	33%
Kryesisht i sigurt	26%
Deri diku	29%
Kryesisht i pasigurt	7%
Shumë i/e pasigurt	4%
Nuk e di/Nuk kam mendim	1%



## NDËRSA PËRDOR INTERNETIN

Shumë i/e sigurt	23%
Kryesisht i sigurt	24%
Deri diku	28%
Kryesisht i pasigurt	10%
Shumë i/e pasigurt	9%
Nuk e di/Nuk kam mendim	6%






Nëpërmjet pyetjeve të paracaktuara mbi fenomenet që rrezikojnë komunitetin dhe si i vlerësojnë ato si kërcënime për komunitetet e tyre të menjëhershme. Prandaj, kërcënimi më i lartë për komunitetet e tyre, siç perceptohet nga të anketuarit, është **migrimi i të rinjve dhe profesionistëve (largimi i trurit)** me 83 përqind të të anketuarve që e vlerësojnë si kërcënim ose kërcënim të lartë. Kjo mund t' i atribuohet kryesisht migrimit të kosovarëve në vendet evropiane dhe më gjerë (d.m.th. në Gjermani dhe vende të tjera) dhe kanosjes së humbjes së kapitalit njerëzor në fushat profesionale,<sup>1</sup> siç janë sektori i shëndetësisë dhe inxhinierisë, si dhe fuqia punëtore shumë e kualifikuar, me çka, ngjashëm me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova është shumë e prekur nga fenomeni i migrimit të punës në vitet e fundit.<sup>2</sup>

**Kafshët endacake** renditen si kërcënimi i dytë më i lartë për sigurinë publike, me 67 përqind të të anketuarve që i vlerësojnë ato si kërcënim ose kërcënim i lartë, dhe kjo shënon ndryshim të rëndësishëm në lidhje me shqetësimin e shprehur në katër vitet e fundit që kur BSBP matë këtë tregues.<sup>3</sup> Shumë nga të anketuarit që i perceptojnë kafshët endacake si kërcënim i lartë e lidhin atë me përvojat personale, përvojat që kanë parë ose raportet e mediave për incidentet e shkaktuara nga qentë endacak.<sup>4</sup>

Fenomeni i kafshëve endacake pasohet nga **abuzimi me drogën**, që shihet si një kërcënim ose kërcënim i lartë nga 57 përqind e të anketuarve, **shërbimet e dobëta të shëndetit publik** nga 56 përqind e të anketuarve dhe **ngacmimi seksual** nga 54 përqind e të anketuarve. Në anën tjetër, disa nga kërcënimet më të ulëta për sigurinë e komunitetit të renditura nga të anketuarit e BSBP përfshijnë **infrastrukturën e dobët**, të vlerësuar si kërcënim ose kërcënim i lartë nga 40 përqind e të anketuarve, **mungesën e ndriçimit publik**, me 39 përqind dhe **dhunën kibernetike** me 35 përqind.

**FIGURA 2 PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE MBI KËRCËNIMET E SIGURISË PUBLIKE**
















	Kërcënim i lartë	Kërcënim	Deri diku kërcënim	Kërcënim i ulët	Kurrfarë kërcënim	Nuk e di/ Nuk kam mendim
 Largimi i trurit	67%	16%	9%	5%	2%	1%
 Kafshët endacake	51%	16%	14%	10%	9%	
 Përdorimi i drogës /varësia prej drogës	37%	20%	14%	10%	17%	2%

1 Grupi i fokusit i mbajtur me hulumtuesit në terren, tetor 2022

2 BPRG (2023) Shëndeti në Kosovë: Emigrimi i Mjekëve dhe Punëtorëve Shëndetësorë, Grupi për Hulumtime të Politikave të Ballkanit Grupi i Kërkimit të Politikave të Ballkanit Gjetet në: <https://balkansgroup.org/en/health-in-kosovo-emigration-of-doctors-and-health-workers/> (Qasur më: 1 shkurt 2023).

3 Balaj, S. (2021) PERCEPTIMET E QYTETARËVE ndej SIGURISË PUBLIKE, KËRCËNIMEVE TË BRENDSHME dhe JASHTME, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Gjetet në: [https://qkss.org/images/uploads/files/Kosovo\\_Edition\\_Eng\\_4\\_15336.pdf](https://qkss.org/images/uploads/files/Kosovo_Edition_Eng_4_15336.pdf) (Qasur më: 1 shkurt 2023).


4 Grupi i fokusit i mbajtur me hulumtuesit në terren, tetor 2022

	Kërcënim i lartë	Kërcënim	Deri diku kërcënim	Kërcënim i ulët	Kurrfarë kërcënimi	Nuk e di/ Nuk kam mendim
 Shërbime të dobëta të shëndetit publik	39%	17%	20%	9%	15%	
 Ngacimi seksual	39%	15%	13%	14%	18%	1%
 Aksidentet e trafikut	29 %	23%	24%	13%	10%	1%
 Përdorimi i armëve ilegale të zjarrit	31%	19%	17%	12%	17%	4%
 Vjedhje shtëpie/ banese	30%	17%	19%	15%	18 %	1%
 Vrasjet	32%	14%	15%	18%	20%	1%
 Diskriminimi gjinor	29%	18%	21%	14%	17%	1%
 Dhuna në familje	28%	17%	19%	14%	21%	1%
 Mungesa e masave të sigurisë në vendet e ndërtimit dhe/ose zonat përreth	27%	19%	22%	15%	15%	2%
 Dhuna në shkolla	25%	19%	20%	17%	17%	2%
 Ndotja	26%	19%	21%	17%	16%	1%
 Trafikimi i qenieve njerëzore	27%	15%	16%	14%	25%	3%
 Ngacimi	24%	16%	20%	17%	21%	2%
 Infrastruktura e dobët	21%	19%	30%	15%	15%	
 Mungesa e ndriçimeve publike në qytet / fshat / lagje	20%	19%	21%	18%	22%	

Duke pasë parasysh zhvillimin politik në vitin 2022 të agresionit të paprovokuar të Rusisë kundër Ukrainës dhe pasojat e tij që ka sjellë krizë ekonomike kryesisht në Evropë, përfshirë Ballkanin Perëndimor, si pasojë, BSBP mati nivelin e shqetësimit midis të anketuarve në lidhje me mungesat e mallrave dhe shërbimeve thelbësore. Të dhënat tregojnë se të anketuarit janë shumë të shqetësuar për **mungesën e energjisë elektrike**, pasuar nga **mungesa e karburantit dhe ngrohjes**, ku 68 dhe 63 për qind e tyre janë kryesisht ose shumë të shqetësuar. Të anketuarit janë të shqetësuar për mungesën e energjisë elektrike për shkak të apeleve të shpeshta të Qeverisë së Kosovës dhe shpërndarësve të energjisë që nga fundi i vitit 2021 dhe veçanërisht në vitin 2022 për kursimin e konsumit të energjisë, duke theksuar kështu kapacitetet e kufizuara të prodhimit të energjisë të termocentraleve aktuale të Kosovës, si dhe paralajmëron se do të ketë krizë dhe ndërprerje të energjisë.<sup>5</sup> Duke iu referuar ushqimit dhe ilaçeve, të anketuarit shprehën më pak shqetësim në lidhje me mungesat e tyre, megjithatë, ata potencojnë në shumicë se rritja e çmimeve në **ushqim dhe ilaçe** ka shumë të ngjarë t'i bëjë ato të papërballeshme për popullsinë në Kosovë.<sup>6</sup>




### FIGURA 3 SHQETËSIMET E TË ANKETUARVE PËR MUNGESAT E GJËRAVE TË DOMOSDOSHME

#### SA JENI TË SHQETËSUAR PËR MUNGESËN:




5 Shabani, V. (2023) Kurti e Rizvanolli me thirrje për Kursimin e Energjisë, thonë se dy Muajt e Ardhsëm janë Kritike, KALLXO.com. KALLXO.com. Gjetet në: <https://kallxo.com/lajm/kurti-e-rizvanolli-me-thirrje-per-kursimin-e-energji-se-thone-se-dy-muajt-e-ardhshem-jane-kritik/> (Qasur më: 1 shkurt 2023).

6 Grupi i fokusit i mbajtur me hulumtuesit në terren, 12 tetor 2022



### NXEHTËSI




# 1.1. KËRCËNIMET DHE RREZIQET NGA COVID-19

Ndërsa rastet e COVID-19 në Kosovë kanë rënë ndjeshëm gjatë vitit 2022, duke ngadalësuar përparimin e pandemisë, anketa e BSBP mati perceptimet e të anketuarve për disa çështje në lidhje me pandeminë COVID-19.

Perceptimet e të anketuarve ishin të ndara kur u pyetën nëse pandemia ende paraqet rrezik për shëndetin e tyre. 46 përqind e tyre shprehën se pandemia nuk paraqet rrezik për shëndetin krahasuar me 35 përqind që thanë ndryshe, dhe 19 përqind të tjerë që u përgjigjën se COVID-19 është deri diku i rrezikshëm. Prandaj, mund të supozohet se rënia e konsiderueshme e numrit të rasteve të raportuara me COVID-19 dhe rasteve të vdekjes, si dhe procesi i vaksinimit kanë pasur ndikim pozitiv tek të anketuarit kur kanë ofruar këto perceptime.

**FIGURA 4** PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE PËR COVID-19 DHE RREZIKUN E TIJ PËR SHËNDETIN E TYRE


**A BESONI SE COVID-19 VAZHDON TË RREZIKOJË SHËNDETIN TUAJ?**



Një tregues tjetër i matur është se si procesi i vaksinimit kundër pandemisë ka kontribuar në pengimin e përparimit të saj. Të anketuarit kanë vështrime të ndryshme, megjithatë, qëndrimi pozitiv dominon, me 45 përqind që besojnë se vaksinat kanë ndihmuar në parandalimin e pandemisë, 23 përqind që besojnë se vaksinimi ndihmoi deri diku, ndërsa 30 përqind e të anketuarve ishin mjaft pesimistë pasi nuk besojnë se procesi i vaksinimit ka pasur ndikim për të penguar pandeminë.

**FIGURA 5** PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE PËR KONTRIBUTIN E VAKSINËS NË FRENIMIN E PANDEMISË

**A KONTRIBUOI VAKSINIMI KUNDËR COVID-19 NË NDALIMIN OSE FRENIMIN E PANDEMISË?**



## 1.2. KËRCËNIMET DHE RREZIQET NGA DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA NË BAZË GJINORE

Edicioni 2022 i sondazhit të BSBP-së prezantoi pyetje të reja në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën në bazë gjinore (DhBGj) në Kosovë. Kështu, QKSS synoi të kuptonte shkaqet e dhunës në familje dhe DhBGj që erdhën si rezultat i përgjigjeve të të anketuarve në edicionin e mëparshëm 2021 të BSBP, në të cilin dhuna në familje dhe ngacmimi seksual u identifikuan si kërcënime të mëdha.<sup>7</sup>

Për më tepër, në vitet e fundit, ndërsa rastet e raportuara të dhunës në familje dhe DhBGj janë rritur, besimi në institucionet gjyqësore që merren me këto raste ka mbetur i ulët.<sup>8</sup> Madje, kapaciteti institucional për të trajtuar rastet e brendshme dhe DhBGj është mjaft i kufizuar dhe brenda këtyre institucioneve ekzistojnë qëndrime të josensitive ndaj çështjeve gjinore.<sup>9</sup> Në vitin 2022 Kosova u përball me disa nga rastet më brutale të vrasjeve të grave, ndër rastet e fundit janë vrasja e një gruaje në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës,<sup>10</sup> si dhe një grua tjetër u vra nga bashkëshorti i saj me sopatë në fillim të fushatës “16 Ditët e Aktivizmit”.<sup>11</sup> Dhuna në familje dhe rastet e DhBGj mbeten sfida të mëdha në Kosovë.

Kur u pyetën nëse ata vetë ose dikush që njohin kanë përjetuar dhunë në familje, vetëm 1 përqind e të anketuarve kanë deklaruar se ata vetë kanë përjetuar dhunë në familje dhe 11 përqind u përgjigjën se e njihnin dikë që ishte ekspozuar ndaj dhunës në familje. Në anën tjetër, 80 përqind e të anketuarve deklaruan se ata kurrë nuk kanë përjetuar personalisht dhunë në familje.

Shumë të anketuar ngurruan t’i përgjigjeshin pyetjes nëse ata ose dikush që njihnin përjeton ndonjëherë dhunë në familje, pasi gjatë procesit të plotësimit të anketës shoqëroheshin nga anëtarë të tjerë të familjes, në prani të të cilëve nuk u ndjenë të lirshëm të ndanin mendimin për këtë çështje.<sup>12</sup>

---

7 Balaj, S. (2021) PERCEPTIMET E QYTETARËVE NDAJ SIGURISË PUBLIKE, KËRCËNIMEVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Gjetet në: [https://qkss.org/images/uploads/files/Kosovo\\_Edition\\_Eng\\_4\\_15336.pdf](https://qkss.org/images/uploads/files/Kosovo_Edition_Eng_4_15336.pdf) (Qasur më: 1 shkurt 2023).

8 Avdimetaj, T. (2023) Raporti bazë mbi dhunën me bazë gjinore në Kosovë: Perceptimet e komunitetit dhe palëve të interesuara, QKSS. QKSS. Gjetet në: <https://qkss.org/en/publikimet/raporti-per-vleresimin-baze-te-dhunes-ne-baza-gjinore-ne-kosove-perceptimet-e-komunitetit-dhe-paleve-te-interesit/> (Qasur më: 1 shkurt 2023).

9 Po aty.

10 Rfë/rl (2022) Vritet një grua shtatzënë në oborrin e QKUK-së, Radio Evropa e Lirë. Radio Evropa e Lirë. Gjetet në: <https://www.evropaelire.org/a/vrasja-e-nje-gruaje-ne-qkuk-/32156048.html> (Qasur më: 11 janar 2023).

11 NACIONALE (2022) Vrasja me sopatë e gruas në Prishtinë: Krejt çka dihet deri Tash, Nacionale. Gjetet në: <https://nacionale.com/sociale/vrasja-me-sepate-e-gruas-ne-prishtine-krejt-cka-dihet-deri-tash> (Qasur më: 11 janar 2023).

12 Grupi i fokusit i mbajtur me hulumtuesit në terren, tetor 2022

**FIGURA 6 PËRGGJIGJET E TË ANKETUARVE PËR PYETJEN NËSE KANË PËRJETUAR DHUNË NË FAMILJE**

**A KENI PËRJETUAR  
NDONJËHERË JU OSE  
DIKUSH QË NJIHNI  
DHUNË NË FAMILJE?**

Po, unë personalisht	1%
Dikush që njoh	11%
Jo	80%
Nuk e di/Nuk kam mendim	8%



Një tjetër pyetje kryesore në këtë drejtim ishte ajo që lidhej me shkaqet e dhunës në familje. Në këtë drejtim, 41 për qind e të anketuarve renditën kushtet e dobëta ekonomike si shkakun kryesor të dhunës në familje. Kur renditën kushtet e dobëta ekonomike si shkakun kryesor, të anketuarit theksuan më konkretisht çështjet e mëposhtme: i) mungesa e pavarësisë ekonomike të grave, duke i detyruar ato të qëndrojnë në familje të dhunshme pa një tjetër alternativë; dhe ii) stresi që rrjedhë nga kushtet e dobëta ekonomike e që perceptohet se çon në sjellje të dhunshme.<sup>13</sup> Më tej, niveli i ulët arsimor renditet si shkak nga 24 përqind e të anketuarve, ndërkohë që ky fenomen është lidhur edhe me mentalitetin dhe kulturën patriarkale.<sup>14</sup> Ai pasohet nga abuzimi me alkoolin dhe drogën (nga 12 përqind e të anketuarve), traditat konservatore (nga 10 përqind e të anketuarve) dhe bllokimi / izolimi për shkak të masave COVID-19 (nga 2 përqind). Përafërsisht 10 përqind e të anketuarve nuk kishin asnjë mendim për këtë çështje.

**FIGURA 7 PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE MBI SHKAQET E DHUNËS NË FAMILJE**

**SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILAT  
JANË SHKAQET E RRIJTJES SË  
DHUNËS NË FAMILJE NË VENDIN  
TUAJ?**

Kushtet e këqija ekonomike	41%
Niveli i arsimit	24%
Abuzimi me alkoolin dhe drogën	12%
Traditat konservatore	10%
Izolimi për shkak të COVID-19	2%
Nuk e di/Nuk kam mendim	9%
Të tjera	2%

Për më shumë, të anketuarit dhanë qëndrimet në lidhje me masat që duhet të merren nga institucionet për të parandaluar dhunën në familje. Rritja e cilësisë së arsimit perceptohet si një masë e nevojshme që duhet të merret nga 41 për qind e të anketuarve. Fushatat e vetëdijesimit kundër dhunës në familje, si në shkolla ashtu edhe në qytete ose fshatra, shihen po ashtu si masë e rëndësishme nga 15 dhe 14 përqind e të anketuarve, respektivisht. Nëntë përqind e tyre besojnë se punëtorët e vijës së parë që adresojnë dhunën në familje duhet të trajnohen më tej për qasjen e ndjeshme gjinore dhe 7 përqind të tjerë theksuan rritjen e përfaqësimit të grave në institucionet e sigurisë si mjet për të parandaluar dhunën në familje.


<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty.



**FIGURA 8** PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE MBI MASAT INSTITUCIONALE QË DUHET TË MERREN KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

**SIPAS MENDIMIT TUAJ, ÇFARË MASASH DUHET TË MARRIN INSTITUCIONET E VENDIT TUAJ PËR TË PARANDALUAR DHUNËN NË FAMILJE?**




## 2. KËRCËNIMET E SIGURISË KOMBËTARE

Trazirat prej luftës në Ukrainë shkaktuan probleme në mbarë botën dhe përkeqësuan ato ekzistueset, si bllokimin e tregtisë së grurit në fillim të luftës, ndryshimin e çmimeve të naftës, furnizimet e kufizuara të mallrave, të cilat si rezultat thelluan krizën e urisë në shumë rajone të botës.<sup>15</sup> Çmimet e mallrave u prekën edhe në Kosovë dhe priirja e përgjithshme e dezinformimit me shpërthimin e luftës, potencialisht shkaktoi panikë se kjo ngjarje mund të ketë efekt përhapjeje në Kosovë. Kjo u pasqyrua në përgjigjet e të anketuarve ndaj sondazhit të BSBP 2022, ku shumica dërrmuese e të anketuarve – 87 përqind – e konsiderojnë **rritjen e çmimeve të produkteve** si kërcënim/kërcënim të lartë për sigurinë kombëtare, ndërkohë që vetëm më pak se një përqind nuk shohin asnjë kërcënim prej saj, duke e shënuar atë si kërcënimin më të lartë të perceptuar për sigurinë kombëtare të Kosovës. Ngjashëm, të anketuarit e perceptojnë **krizën energjetike** si shumë problematike, për shkak se 86 përqind e të anketuarve e vlerësojnë atë si kërcënim ose kërcënim të lartë për sigurinë kombëtare. Megjithatë, më pak të anketuar (58 përqind) e rendisin **luftën në Ukrainë** si kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës; dhe, përkatësisht, 57 përqind e të anketuarve besojnë se **potenciali për përshkallëzim në rajon** është kërcënim ose kërcënim i lartë për sigurinë kombëtare.
















Kërcënimi i rritjes së çmimeve dhe kriza energjetike ndiqet nga afër nga **trafikimi i drogës**, i vlerësuar si kërcënim ose kërcënim i lartë nga 86 përqind e të anketuarve. Ngjashëm, **kriza ekonomike** shihet si kërcënim ose kërcënim i lartë nga 84 përqind e të anketuarve, dhe 82 përqind e tyre e vlerësojnë **krimin e organizuar** si shumë kërcënues për sigurinë kombëtare.

Anasjelltas, kërcënimet kombëtare me vlerësimin më të ulët përfshijnë **ndotjen dhe ndryshimet klimatike**, të cilat vlerësohen si kërcënim ose kërcënim i lartë nga 56 përqind e të anketuarve, si dhe **ekstremizmin e dhunshëm** (nga 56 përqind). Fenomeni i perceptuar si më pak kërcënues nga të anketuarit e BSBP është **COVID-19**, i cili shihet si kërcënim ose kërcënim i lartë nga 35 përqind e të anketuarve, ndërsa 43 përqind e tyre shohin kërcënim të ulët ose aspak kërcënim.

**FIGURA 9 PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE MBI KËRCËNIMET E SIGURISË KOMBËTARE**

<b>SA E VLERËSONI TË MËPOSHTMEN SI KËRCËNIM PËR SIGURINË KOMBËTARE?</b>		Aspak kërcënim	Kërcënim i ulët	Deri diku kërcënim	Kërcënim	Kërcënim i lartë	Nuk e di/ Nuk kam mendim
	Korrupsioni	1%	4%	14%	22%	58%	1%

<sup>15</sup> Komiteti, IR (2022) Lufta e Ukrainës: Cilat janë ndikimet në botën e sotme? Në IRC. Gjetet në: <https://www.rescue.org/article/ukraine-war-what-are-impacts-world-today> (Qasur më: 11 janar 2023).

	Krimi i organizuar	2%	4%	11%	23%	59%	1%
	Trafikimi i paligjshëm i armëve të zjarrit	2%	5%	13%	27%	50%	3%
	Trafikimi i drogës	1%	3%	8%	24%	62%	2%
	Papunësia	4%	4%	13%	16%	63%	
	Pandemia COVID-19	26%	17%	22%	14%	20%	1%
	Ekstremizmi dhe terrorizmi i dhunshëm	10%	13%	19%	20%	35%	3%
	Migrimi dhe largimi i trurit	4%	5%	12%	14%	64%	1%
	Kriza ekonomike	2%	3%	11%	18%	66%	
	Ndotja dhe ngrohja globale	7%	9%	26%	25%	31%	2%
	Lajmet e rreme	3%	4%	17%	25%	50%	1%
	Kërcënimet e sigurisë kibernetike	4%	7%	19%	25%	39%	6%
	Lufta në Ukrainë.	7%	10%	23%	22%	36%	2%
	Potenciali për përshkallëzime në rajon	7%	8%	25%	29%	28%	3%
	Rritja e çmimeve të mallrave	1%	3%	8%	15%	72%	1%
	Kriza energjetike	2%	3%	9%	18%	68%	

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

351.75(496.51)(047)

Fetiu, Dea

Perceptimet e të anketuarve mbi sigurinë publike dhe kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë / Dea Fetiu, Dorjeta Rukiqi. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2023. - 17 f. ; 24 cm.

Ruajtja e rendit publik -- Raporte, intervista -- Kosovë

**ISBN 978-9951-799-92-8**



ISBN 978-9951-799-92-8



9 789951 799928